

VENDIM
Nr.452, datë 9.7.2004

**PËR KRITERET E DHËNIES SË KREDISË PËR STREHIM USHTARAKUT TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MASËN E KËSAJ KREDIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret për dhënien e kredisë për strehim nga Ministria e Mbrojtjes ushtarakut të pastrehë apo me sipërfaqe të pamjaftueshme banimi të Forcave të Armatosura janë:

- a) Grada e ushtarakut;
- b) Mundësitë financiare për garantimin e kthimit të kredisë;
- c) Renditja si më poshtë vijon:
 - i) ushtarakët aktivë;
 - ii) ushtarakët në rezervë;
 - iii) ushtarakët në lirim apo pension.

2. Trajtimi me kredi për strehim bëhet nëpërmjet sistemit të kredive me fondet që Ministria e Mbrojtjes siguron nga të ardhurat e veta.

3. Ministria e Mbrojtjes, për livrimin e kredisë, mund të negociojë me bankat për arritjen e marrëveshjeve në kushte lehtësuese.

4. Për përfitimin e kredisë, ushtaraku duhet të paraqesë dokumentet si më poshtë vijon:

Ushtaraku i pastrehë:

- a) Kërkesën personale;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- ç) Dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale dhe të personave në ngarkim të tij;
- d) Vërtetimin se nuk ka pasuri të paluajtshme në emër të tij apo të personave në ngarkim të tij.

Ushtarakët që kërkojnë kredi për shtesë të sipërfaqes së banimit:

- a) Kërkesën personale;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- ç) Dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale;
- d) Aktin e pronësisë së banesës ekzistuese.

5. Kur ushtaraku e ndërton vetë banesën duhet të paraqesë dokumentacionin sipas ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar.

6. Masa e kredisë të jetë si më poshtë vijon:

a) Për ushtarakun e pastrehë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, me interes 3 për qind dhe afat kthimi deri në 25 vjet;

b) Për ushtarakun që kërkon kredi për shtesë të sipërfaqes së banimit deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, me interes 3 për qind, afat kthimi deri në 15 vjet.

7. Kredia të shlyhet me kësht mujor, i cili të mos jetë më i lartë se 30 për qind e të ardhurave mujore familjare.

8. Në strukturat e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të ngrihen komisionet bazë për dhënien e kredisë që, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim, të shqyrtojnë dhe të përgatisin dokumentacionin e duhur për dhënien e kredisë ushtarakut, i cili i dërgohet për shqyrtim komisionit qendror për dhënien e kredisë.

9. Në Ministrinë e Mbrojtjes të ngrihet komisioni qendror për dhënie kredie, i cili pasi shqyrton dokumentacionin e përgatitur nga komisionet bazë propozon ushtarakët përfitues dhe masën e kredisë.

Komisionet e përcaktuara në pikat 8 e 9 të ngrihen me urdhër të titullarëve të strukturave përkatëse.

11. Lista emërore e ushtarakëve përfitues miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.

12. Ushtarakët që janë trajtuar apo do të trajtohen me kredi sipas vendimit nr.102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore", nuk përfitojnë kredi sipas këtij vendimi.

13. Vendimi nr.58, datë 23.1.2003 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me strehim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura" shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano